



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Personat e Pagjetur dhe Peticione
Nr. 0-10
Prishtinë, më 27. 5. 2008, në orën 13:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P R O C E S V E R B A L

i mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione

Morën pjesë: Ismet Beqiri - kryetar, Hajredin Hyseni, Radmila Vujoviç, Sanije Alijaj, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Nerxhivane Dauti, Naim Rrustemi, Drita Maliqi Shpresa Murati dhe Vezira Emrush - anëtarë.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Jennifer Ober dhe Elita Vokshi – nga OSBE-ja,
Xhemajl Ahmeti – nga UNHCR-i,
Javler Leoz Invernin nga - OHOHR - Human right officer dhe
Fitore Zeneli – nga KDI

Kryetari ia propozoi Komisionit këtë

REND DITE

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes se kaluar,
2. Përkrahja e OSB-së për Komisionin,
3. Caktimi i datës për një vizitë të Komisionit në familjet që kanë persona të pagjetur në Krushë të Madhe,
4. Shqyrtimi i peticioneve: nr. 01-227,02 -3661, nr. 02-3920, nr. 02-3638 dhe 02-3878

Komisioni vendosi që pikën e tretë të rendit të ditës të mos e shqyrtojë dhe e autorizoi kryetarin që ta caktojë datën e vizitës në Krushë të Madhe.

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

U hap diskutimi për pikën e parë.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

2. Përkrahja e OSB-së për Komisionin

Ismet Beqiri – E përshëndeti znj. Jennfer Ober nga OSB-ja për pjesëmarrje në mbledhje, i njoftoi anëtarët në vija të trasha lidhur me pikën e rendit të ditës që do të debatohet dhe i ftoi ta marrin fjalën.

Znj. Jennfer Ober - Nënvizoi se Misioni i OSBE-së në Republikën e Kosovës është i gatshëm të ofrojë këshilla ligjore, shërbime teknike për të gjitha çështjet lidhur me procesin legjislativ, për seminarët njëditore, për procesin legjislativ dhe për teknikat e hartimit dhe të shqyrtimit të legjislacionit. Për zhvillimin e politikave jemi të gatshëm t'ju ofrojmë këshilla në aspektet strategjike, si për marrjen e nismave që ju i konsideroni të nevojshme. Ajo veçmas e ofroi ndihmën në amendamentimin e Ligjit për barazi gjinore si dhe për monitorimin e zbatimit të tij. E sheh të nevojshëm hartimin e Projektligjit për personat e pagjetur dhe kërkoi që më parë të organizohet një tryezë e rrumbullakët me ekspertët ligjorë të të drejtave të njeriut ku asistenca e OSB-së në këto katër fusha do të jetë e dobishme për Komisionin.

Ismet Beqiri – E falënderoi mysafiren dhe ceku se me shkrim do t'ju drejtohem për ofrimin e ndihmës profesionale.

Z. Ibrahim Makolli – Kërkoi nga znj. Jennfer Ober t'i mundësohet Komisionit për vizitë pune në Vershavë, pasi konsideron se atje gjen material lidhur me të drejtat e njeriut. Me propozimi i tij që u mirëprit nga kryetari dhe të tjerët kërkoi vizita studimore jashtë Kosovës.

Elita Vokshi – Propozoi takim me zëvendësin e Avokatit të Popullit, para se të bëhet emërimi i tij. Në vazhdim i premtoi Komisionit se OSB-ja do t'ia dërgojë raportet mujore.

Ismet Beqiri - E mirëpriti ndihmën lidhur me raportet mujore që i ceku parafolësja dhe shtoi: Komisioni kohë më parë e ka mbajtur takimin me zëvendësuesin e Avokatit të Popullit, z. Hilmi Jashari dhe e ka njoftuar Komisionin lidhur me gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Konstatim i përgjithshëm në këtë pikë ishte që të zhvillohet bashkëpunimi ndërmjet Komisionit dhe OSB-së.

3. Shqyrtimi i peticioneve nr. 01-227,02 -3661, nr. 02-3920 nr. 02-3638 dhe 02-3878

Nerxhivane Dauti – I njoftoi anëtarët me përmbajtjen e peticioneve dhe me rekomandimet e dhëna të secilit peticion që u mirëpritën. Në këtë kontekst ceku se lidhur me shqyrtimin e dy peticioneve duhet të organizohet dëgjim publik, në të cilin do të ftohen palët – përfaqësuesja e Habitatit dhe MPMS (Besime Rrecaj) dhe znj. Halime Tashevi. Lidhur me peticionin e punëtorëve të arsimit të komunës së Kastriotit, Komisioni konsideron se nuk ka objekt pasi ligji nuk është nënshkruar dhe nuk ka hyrë në fuqi. Komisioni lidhur me peticionin e z. Krasniqit, kërkon që serish t’ia rekomandojë Gjykatës komunale për zbatimin e aktgjykimit të plotfuqishëm.

Vezira Emrush - Duke u ndërlidhur me peticionin e z. Krasniqit për moszbatimin e aktgjykimit për kthimin në vendin e punës, duke e cilësuar si veprimin jo të mirë, kërkoj që të merren masa preventive në këtë drejtim. Komisioni vendosi brenda kohës së shkurtër të caktohet data e mbajtjes së dëgjimit për dy peticionet e lartpërmendura.

Mbledhja përfundoi në orën 14:40.

Procesverbalin e hartoi

Rrahim Demaj - zyrtar i lartë ligjor

Kryetari i Komisionit
Ismet Beqiri